

Progres Raporti i KE-së vlerëson miratimin e ligjit për sigurimin e detyrueshëm

Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, janar–shtator 2021
- Ecuria e tregut të titujve të Qeverisë, janar–shtator 2021

Zhvillime të tjera

- AMF në takimet vjetore të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore
- “Java Botërore e Investitorit 2021” – AMF pjesëmarrëse në disa aktivitete
 - Përmbillet projekti “Ne flasim gjuhën e tregjeve financiare”
 - 15 ekipe studentësh nisin lojën në bursën virtuale të titujve
- AMF nxjerr për konsultim dhe miraton rregulloren “Për komisionet e ndërmjetësimit”
- Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së në takim *online* me misionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar

Publikime Profesionale

- “Global Risk Regulator”
 - Autoritetet rregullatore kanë shtuar përpjekjet për “të pastruar” *kriptot*, ndërkohë që ato kanë filluar të qarkullojnë edhe në kanalet kryesore të lëvizjes së parasë
 - ESMA sfidon skeptikët e obligacioneve për të vendosur rregulla më të ashpra lidhur me transparencën
 - Kriptomonedhat do të tronditin sistemet e pagesave
- “Journal of Risk Management in Financial Institution” - Volumi 14, Nr. 3

Informacione Ndërkombëtare

- Bosnje-Hercegovinë
- Kroaci
- Mali i Zi
- Rumani
- Serbi
- Slloveni
- Turqi

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

Progres Raporti i KE-së vlerëson miratimin e ligjit për sigurimin e detyrueshëm



Komisioni Evropian, në Progres Raportin për Shqipërinë, ka vlerësuar miratimin e Ligjit 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”. Në gjetjet e Kapitullit 9 “Shërbimet Financiare”, raporti nënvizon se “... është bërë progres në lidhje me rekomandimet e vitit të kaluar përmes miratimit të ligjit për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

Më tej, raporti thekson se ligji i cili hyri në fuqi në korrik 2021 është në përputhje me legjislacionin e BE-së. Dokumenti përmend gjithashtu masat e marra nga Autoriteti për të garantuar stabilitetin financiar të tregjeve në kuadër të pandemisë COVID-19, duke veçuar vendimin e Bordit për pezullimin e shpërndarjes së fitimit të vitit 2020 nga shoqëritë e sigurimit, në formën e dividendit apo në çdo formë tjetër pagesash.

Në lidhje me infrastrukturën e tregut financiar, konstatohet se Bursa Shqiptare e Titujve vijon të operojë vetëm me tregtimin e titujve qeveritarë. Gjithashtu, theksohet se Regjistri Shqiptar i Titujve (ALREG) plotëson infrastrukturën e pastregtimit, përmes klerimit/shlyerjes së titujve joqeveritarë.

Në dokument përmenden ligjet e reja të miratuara për tregjet e kapitalit, sipërmarrjet e investimeve kolektive dhe tregjet financiare të bazuara në regjistrat e shpërndarë. Progres Raporti konstaton se në zbatim të ligjit për sipërmarrjet e investimeve kolektive, janë miratuar aktet nënligjore për investimet kolektive, rastet e pezullimit, menaxhimin të rrezikut dhe procedurat e licencimit. Gjithashtu është miratuar ligji për tregjet e kapitalit, shoqëruar me 5 rregullore në zbatim të tij. Këto akte përafrojnë pjesërisht kuadrin ligjor të Shqipërisë me Direktivën MiFID II dhe legjislacionin e BE-së për transparencën, manipulimin e tregut, prospektet, mbi shlyerjen dhe depozitarët qendrorë të titujve.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, janar-shtator 2021


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar-shtator 2021 kapën vlerën 14,166 milionë lekë, ose 18.06% më shumë se në janar-shtator 2020. Gjatë periudhës janar-shtator 2021, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 849,732 me një rritje prej 22.53% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 92.6% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës kanë 7.23%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 39.35% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 60.65% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-shtator 2021, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 5,171 milionë lekë, ose 7.21% më pak se në periudhën janar-shtator 2020, ndikuar kryesisht nga pagesa e pjesës më të madhe të dëmshpërblimeve për tërmetet e fund vitit 2019, gjatë vitit të kaluar.

Ndërkohë dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për periudhën janar-shtator 2021 kapën vlerën 3,025 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 42% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Struktura e tregut të sigurimeve, janar-shtator 2021 (Në %)



Dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për periudhën u rritën me rreth 42% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Ecuria e tregut të Titujve të Qeverisë, janar-shtator 2021

Vëllimi i tregut sekondar të titujve të Qeverisë për periudhën janar-shtator 2021, u dominua në masën 66.40% nga transaksione në instrumente afatshkurtër (bono thesari) dhe 33.60% nga transaksionet në instrumente afatgjatë (obligacione). Parë nga këndvështrimi i numrit të transaksioneve, 80.80% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të titujve të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera në bono thesari.

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të titujve të Qeverisë për periudhën janar-shtator 2021, flasin për një dominim të transaksioneve “Blerje në tregun primar” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” përkatësisht me 52.57% dhe 34.51% kundrejt vëllimit të përgjithshëm. Pjesëmarrja në tregun sekondar të titujve të Qeverisë, për periudhën janar-shtator 2021 dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 99.02% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.


Dy grupet e transaksioneve B dhe C

Transaksioni i llojit B “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” gjatë periudhës janar-shtator 2021, ka pasur një ulje prej 657 milionë lekë ose 26.57% krahasuar me periudhën janar-shtator 2020. Numri i transaksioneve i llojit B është ulur në masën 22.80%.

Transaksioni i llojit C “Blerje para afatit të maturimit” gjatë periudhës janar-shtator 2021, ka pasur një ulje prej 465 milionë lekë ose 23.09%, ndërkohë pati gjithashtu ulje në numrin e transaksioneve në masën 5.77%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në totalin e transaksioneve të llojit B dhe C të marra së bashku, vihet re një ulje në vlerë absolute me rreth 1,122 milionë lekë, krahasuar me periudhën janar-shtator 2020.

Tregu i Titujve të Qeverisë, janar-shtator 2021 (Në %)



Pjesëmarrja në tregun sekondar të titujve të Qeverisë, për periudhën janar-shtator 2021 dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 99.02% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

AMF në Takimet Vjetore të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore



15 tetor 2021 – Nga takimet vjetore *online* të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, z. Ervin Mete, mori pjesë në takimet vjetore me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Bankën Botërore (BB), zhvilluar në formatin *online*.

Diskutimet e këtyre takimeve u përqendruan në ecurinë e ekonomisë shqiptare, situatën në tregjet financiare, si edhe pritshmëritë lidhur me treguesit ekonomikë për të ardhmen.

Në veçanti, tregjet financiare nën mbikëqyrjen e Autoritetit i janë rikthyer normalitetit, referuar treguesve dhe ecurisë së tyre përgjatë vitit 2021. Këto tregje paraqiten të mirëkapitalizuar dhe me nivel të mirë likuiditeti.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së falenderoi drejtuesit e FMN-së dhe BB-së për asistencën dhe mbështetjen e vazhdueshme në drejtim të Autoritetit.

Përfaqësuesit e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore vlerësuan se Shqipëria u rezistoi efekteve të pandemisë dhe tregjet financiare paraqiten të qëndrueshme.

Duke iu referuar treguesve dhe ecurisë gjatë vitit 2021, tregjet financiare nën mbikëqyrjen e AMF-së i janë rikthyer normalitetit.

Përmbillet projekti “Ne flasim gjuhën e tregjeve financiare”



7 tetor 2021 – Përmbillet projekti “Ne flasim gjuhën e tregjeve financiare”.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare mbetet i orientuar në nismat që synojnë rritjen e ndërgjegjësimit dhe informimit për tregjet financiare nën mbikëqyrje, ndërkohë që në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë është angazhuar në hartimin e një strategjie gjithëpërfshirëse për edukimin financiar

Në kuadër të “Javës Botërore të Investitorit”, nën kujdesin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe në bashkëpunim me shoqatat e tregjeve nën mbikëqyrje dhe organizatën “Junior Achievement Albania” u zhvillua aktiviteti “Ne flasim gjuhën e tregjeve financiare”. Përgjatë një viti, gjimnazistë dhe maturanët nga shkollat e mesme në qytete të ndryshme të vendit u përfshinë në hartimin e një fjalorthi me terma dhe koncepte themelore për tregjet financiare, shprehur në një gjuhë të thjeshtë e të përshtatshme për grupmoshën e tyre.

Në ceremoninë e ndarjes së vlerësimeve, Znj. Mimoza Kaçi, Nëndrejtorë Ekzekutive e AMF-së shprehu mbështetjen për iniciativë të tillë, të cilat synojnë angazhimin dhe përfshirjen direkte të të rinjve, duke kontribuar në rritjen e njohurive të tyre për tregjet financiare.

Znj. Kaçi theksoi se Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare mbetet i orientuar në nismat që synojnë rritjen e ndërgjegjësimit dhe informimit për tregjet financiare nën mbikëqyrje, ndërkohë që në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë është angazhuar në hartimin e një strategjie gjithëpërfshirëse për edukimin financiar. Ajo u shpreh se Autoriteti është përfshirë në vijimësi në aktivitete në funksion të rritjes së edukimit financiar, ndërsa ka koordinuar dhe mundësuar kryerjen e praktikave mësimore për të rinjtë në subjektet që operojnë në tregjet nën mbikëqyrje. Në këtë kuadër, Autoriteti do të ofrojë mundësinë e praktikave mësimore pranë AMF-së edhe për pjesëtarët e skuadrës fituese të iniciativës “Ne flasim gjuhën e tregjeve financiare”.

AMF ndër vite ka qënë aktive në “Javën Botërore të Investitorit”, gjatë së cilës ndërmerren nisma në shumë vende të botës, me qëllim promovimin e edukimit financiar dhe mbrojtjes së investitorëve. Gjatë kësaj jave, AMF ka vijuar gjithashtu trajnimet për edukimin në vazhdim të profesionistëve të fushës, me qëllim thellimin e njohurive të tyre për tregjet financiare jobankare, me fokus të veçantë ndryshimet e fundit ligjore dhe rregullatore.

“Java Botërore e Investitorit 2021” – Nis loja virtuale e bursës së titujve



8 tetor 2021 – Nis loja në bursën virtuale të titujve

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare mori pjesë në eventin që shënoi fillimin e lojës virtuale të Bursës, organizuar nga Fondacioni Gjerman Sparkassen për Bashkëpunim Ndërkombëtar (DSIK Albania) dhe Bursa Shqiptare e Titujve (ALSE), si pjesë e nismave për “Javën Botërore të Investitorit”. Shqipëria merr pjesë për herë të parë në këtë konkurs ndërkombëtar, e përfaqësuar nga skuadrat e studentëve nga 15 universitete publike e private.

Në fjalën e mbajtur në këtë aktivitet, znj. Mimoza Kaçi, Nëndrejtorë Ekzekutive e AMF-së vlerësoi angazhimin e të rinjve për të thelluar dhe për të përdorur në praktikë njohuritë për tregjet e kapitalit, të marra gjatë studimeve universitare. Ajo u shpreh se përfshirja e studentëve në lojën virtuale do t’u japë mundësi atyre të njohin nga afër mekanizmat dhe mënyrën e tregtimit të instrumentave financiarë në Bursë.

Gjatë vitit 2020, u miratua paketa e re legislative për tregjet e kapitalit dhe për sipërmarrjet e investimeve kolektive, e cila krijon mundësi për zhvillime të reja në tregjet financiare jobankare.

Përgjatë konkursit, skuadrat pjesëmarrëse nga vende të ndryshme të botës do të hyjnë në një platformë virtuale të centralizuar, e cila do t’i pajisë me fonde virtuale, që mund t’i investojnë në portofole të titujve me çmime reale tregtimi. Në fund, një juri e pavarur ndërkombëtare do të vlerësojë performancën e portofolëve virtualë të investimeve dhe do të shpallë skuadrën fituese. Autoriteti do t’u mundësojë studentëve të skuadrës fituese nga Shqipëria zhvillimin e praktikave mësimore pranë AMF-së.



Projektakte

Faqe Kryesore - Legjislati - Projektakte - Projektregullore "Për komisionet e ndërmjetësimit"

Projektregullore "Për komisionet e ndërmjetësimit"

Materiali i plotë

VERIFIKONI POLICËN TUAJ

DEPOZITO ANKESËN ONLINE

Projektrregullorja
gendet në:

<https://amf.gov.al/projekt.asp?id=76>

AMF nxjerr për konsultim publik dhe miraton rregulloren "Për komisionet e ndërmjetësimit"

Autoriteti i Mbrojtjes Financiare në zbatim të Ligjit nr. 32/2021 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit" ka hartuar projektregulloren "Për komisionet e ndërmjetësimit". Dokumenti publikohet në faqen zyrtare të Autoritetit, për konsultim publik, në linkun: <https://amf.gov.al/projekt.asp?id=76>

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i nivelit maksimal të komisioneve të ndërmjetësimit nga kontratat e sigurimit të detyrueshëm motorik në sektorin e transportit.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së takim *online* me Misionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar



1 tetor 2021 - Takim *online* me misionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar

Ecuria e tregjeve financiare jobankare, plotësimi i kuadrit rregullator dhe asistenca teknike e Fondit Monetar Ndërkombëtar ishin çështjet kryesore të diskutuara në takimin mes z. Ervin Mete, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së dhe Drejtueses së Misionit të FMN-së për Shqipërinë, znj. Yan Sun.

Z. Mete u shpreh se vërehet një përmirësim i vazhdueshëm i treguesve teknikë e financiarë të shoqërive në tregjet nën mbikëqyrje. Gjithashtu në muajt e parë të vitit 2021 është shënuar rritje e të ardhurave dhe asetëve të shoqërive që operojnë në këto tregje, si në krahasim me vitin 2020, ashtu edhe me vitin 2019. Autoriteti ka përparuar me procesin e hartimit dhe miratimit të akteve rregullatore sipas afateve të përcaktuara ligjore.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv falenderoi Drejtuesen e Misionit të FMN-së për asistencën teknike ndaj Autoritetit, në funksion të ndërtimit të një kornize efektive rregullatore dhe mbikëqyrëse, në zbatim të ligjit për tregjet financiare të bazuara në regjistrat e shpërndarë.

Drejtuesja e misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar znj. Yan Sun shprehur gadishmërinë për të vijuar bashkëpunimin dhe asistencën me fokus forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit dhe plotësimin e kuadrit nënligjor. Misioni i FMN-së vlerësoi se masat rregullatore të Autoritetit kanë qenë të përshtatshme, në funksion të monitorimit të kujdesshëm të treguesve dhe garantimit të stabilitetit financiar.

—○○○—
Drejtuesja e misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar znj. Yan Sun shprehur gadishmërinë për të vijuar bashkëpunimin dhe asistencën me fokus forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit dhe plotësimin e kuadrit nënligjor.

—○○○—

<https://www.globalriskregulator.com/Subjects/Financial-Markets/Regulators-move-to-clean-up-crypto-as-it-goes-mainstream>

<https://www.globalriskregulator.com/Subjects/Financial-Markets/ESMA-defies-bond-sceptics-to-impose-tougher-transparency-rules>

<https://www.globalriskregulator.com/Subjects/Financial-Markets/Cryptocurrencies-set-to-shake-up-payment-systems>

Global Risk Regulator

A SERVICE FROM THE BANKER

Search the site ...

FCA 'grey area' crackdown
Could it choke SME lending?



Home

Subjects

Regions

Blog

Video

Subjects / Financial Markets

Regulators move to clean up crypto as it goes mainstream

Justin Pugsley | October 1, 2021



Regulators are stepping up moves to clean up the crypto sector, making it more palatable for supervised financial firms to get involved, but such is its rapid development that there are still fears of potential pitfalls for the financial system.

- Autoritetet rregullatore kanë shtuar përpjekjet për të pastruar kriptot, ndërkohë që ato kanë filluar të qarkullojnë edhe në kanalet kryesore të lëvizjes së parasë**

Justin Pugsley

Rregullatorët po rrisin përpjekjet për të pastruar sektorin e kriptove, duke e bërë më të lehtë përfshirjen e firmave financiare të mbikëqyrura, por zhvillimi i shpejtë i këtij sektori është i tillë që ka ende frikë për gracka të mundshme për sistemin financiar.

- ESMA sfidon skeptikët e obligacioneve për të vendosur rregulla më të ashpra të transparencës**

Farah Khaliq

Pavarësisht kundërshtimit të gjerë, rregullatori i tregjeve të letrave me vlerë të BE-së, ESMA ka çuar më tej rekomandimet e saj për të tërhequr më shumë obligacione të tregtueshme në rrjetin e transparencës para dhe pas tregtimit. Skeptikët thonë se është shumë herët për të imponuar kërkesa më të mëdha raportimi dhe se kjo do të godasë në mënyrë të padrejtë tregun.

- Kriptomonedhat do të tronditin sistemet e pagesave**

Stephanie Ramezan and Ekaterina Daminova

Ndërsa investitorët vazhdojnë të lundrojnë në valën e kriptomonedhave, kompanitë po pranojnë gjithnjë e më shumë bitcoin për qëllime transaksioni. Një vlerësim ndërkombëtar sugjeron se më shumë se 15,174 biznese në mbarë botën po e bëjnë këtë tani, gjë që ka implikime për sistemet e pagesave.

HENRYSTEWART PUBLICATIONS REGISTER FOR UPDATES >

HOME | ALL JOURNALS | FINANCE | MANAGEMENT | MARKETING | DIGITAL | REAI | ESTATE / PROPERTY

Volume 14 (2021)

Each volume of *Journal of Risk Management in Financial Institutions* consists of four 100-page issues, published both in print and online.

The papers and case studies confirmed for volume 14 are listed below:

Volume 14 Number 4

- Editorial**
John Kerry, Publisher
- Papers**
Fixed-income ETFs: A liquidity illusion?
Aravind Heine, Head of Operations, Fixed Income, Discretionary and Credit Portfolio Manager, Lombard-Odier Investment Managers and Stephen Satchell, Trinity College, Cambridge


ABSTRACT >

- COVID-19 government support reinforces zombification**
John Lorie, Chief Economist and Julian Ciobica, Economist, Atradius

ABSTRACT >

- Shifting paradigms: Regionalisation and the post-COVID-19 risk matrix**
Guillaume Barthe-Dejean, Director of the Chairman's Office, SK Group

SUBSCRIBE NOW >



DETAILS

Call for articles
Call for Papers - Advances in ESG, Integration, Risk Management and Thematic Investing
Contact us
Editorial Board
Submitting content
Instructions for authors
Multi-user licences


Revista “Menaxhimi i Riskut në Institucionet Financiare” (*Journal of Risk Management in Financial Institutions*)

Volume 14, (2021) Numri 4

<https://www.henrystewartpublications.com/>

Ky numër përmban ndër të tjera edhe artikujt e mëposhtëm:

- ETF (*Exchange-traded funds*) me të ardhura fikse: Një iluzion likuiditeti?**
Anando Maitra, Drejtues i hulumtimeve gjithëpërfshirëse mbi të ardhurat fikse dhe menaxher i portofolit të kredisë; Lombard-Odier Menaxher Investimesh; Stephen Satchell, Trinity College, Cambridge
- Mbështetja e qeverisë për COVID-19 përforcon zombifikimin.**
John Lorie, Drejtues, Ekonomist; Iulian Ciobica, Ekonomist, Atradius
- Paradigmat e zhvendosura: Rajonizimi dhe matrica e rrezikut pas COVID-19.**
Guillaume Barthe-Dejean, Drejtor i Zyrës së Kryetarit, SK Group
- Transformimi dixhital në thesar, rreziqet dhe financat: COVID-19 do të ndikojë në përshpejtimin e krijimit të qendrave analitike të zgjuara në këto departamente.**
Johan von Solms, student PhD i Shkencave Kompjuterike; Josef Langerman, Profesor i Praktikës; Carl Marnewick, Profesor, Universiteti i Johannesburgut
- Arritja e elasticitetit operacional në industrinë financiare: Vështrime nga teoria komplekse e sistemeve adaptive dhe implikimet për menaxhimin e rrezikut.**
Tom Butler, Profesor, University College Cork; Robert Brooks, MD, Accenture
- Rezistenca operationale si një koncept i ri dhe zgjerim i menaxhimit të rrezikut operacional.**
Udo Milkau, Këshilltar Dixhital
- Analizë e librit: Antologjia nga Moorad Choudhry: “Parimet e së shkuarës, të tashmes dhe të ardhmes të Bankës dhe Financave”.**
Analizuar nga Krzysztof Jajuga, Departamenti i Investimeve Financiare dhe Menaxhimit të Riskut, Universiteti i Ekonomisë dhe Biznesit Wroclaw



Revista “Menaxhimi i Riskut në Institucionet Financiare” (Journal of Risk Management in Financial Institutions)

Volume 14, (2021) Numri 4


<https://www.henrystewartpublications.com/>

“Arritja e elasticitetit operacional në industrinë financiare: Vështrime nga teoria komplekse e sistemeve adaptive dhe implikimet për menaxhimin e rrezikut”

Tom Butler, Profesor, University College Cork; Robert Brooks, MD, Accenture

Abstrakt:

Institucionet financiare përballen me trazira të mëdha të ardhura nga rreziqet jofinanciare: Ndryshimi i klimës, COVID-19, Brexit, transformimi dixhital dhe sulmet kibernetike krijojnë kërcënime të reja dhe rrisin dobësitë ekzistuese sistemike dhe organizative. Rregullatorët financiarë po njohin madhësinë e rreziqeve me të cilat përballen institucionet dhe po kërkojnë që ato të bëhen elastike - domethënë, që ata të jenë në gjendje të absorbojnë, përshtaten ose të shërohen nga kërcënimet, streset ose goditjet. Sidoqoftë, kjo është më e lehtë të thuhet sesa të bëhet. Objektivi i këtij punimi është të informojë profesionistët e rrezikut se si mund të arrihet elasticiteti duke siguruar një kuadër referues shumë të nevojshëm për ata që planifikojnë t'i transformojnë organizatat e tyre komplekse dhe kaotike në sisteme adaptive komplekse elastike. Ndër të tjera, studimi përcakton një model logjik, të bazuar në konceptimin e firmave si sisteme adaptive komplekse elastike (RCAS), i cili përpunon kushtet e nevojshme dhe të mjaftueshme për elasticitetin në organizata. Ky model i përgjithshëm mund të zbatohet në fusha thelbësore të operacioneve brenda ndërmarrjeve financiare për t'i bërë ato elastike përballë ngjarjeve të rrezikut endogjen* dhe ekzogjen**, duke përbushur kërkesat rregullatore.



• *Endogjen - Variablat endogjenë përdoren në ekonometri dhe nganjëherë në regresionin linear. Ato janë të ngjashme (por jo saktësisht të njëjta me) variablat e varur. Variablat endogjene kanë vlera që përcaktohen nga ndryshoret e tjera në sistem (këto ndryshore "të tjera" quhen ndryshore ekzogjene)*

** *Ekzogjen - Në një model ekonomik, një ndryshore ekzogjene është ajo, vlera e së cilës përcaktohet jashtë modelit dhe i imponohet modelit. Një ndryshim ekzogjen është një ndryshim në një ndryshore ekzogjene.*

BOSNJE-HERCEGOVINË

www.xprimm.com

Tregu i sigurimeve të Bosnjë-Hercegovinës e mbylli gjysmën e parë të vitit 2021 duke treguar një dinamikë pozitive, veçanërisht në sigurimin e Jetës. Vëllimi i primeve të shkruar bruto në sigurimin e Jetës arriti vlerën rreth 42.8 milionë euro. Megjithëse primet e shkruara bruto të këtij sigurimi u rritën me 12.3% (e shprehur në terma vjetore), ky segment i tregut mbetet ende larg mundësive. Në të njëjtën kohë, dëmet e paguara për sigurimet e Jetës u rritën me 27% (e shprehur në terma vjetore), duke arritur në 21.7 milionë euro.

Sigurimet e Jo-Jetës gjithashtu patën rritje me rreth 8%, duke arritur vlerën e primeve të shkruara bruto në 165 milionë euro. Linjat e sigurimeve motorike ruajtën pozicionin e tyre dominues, me një peshë prej 59% në portofolin e tregut dhe vëllim të primeve të shkruar bruto prej 122.8 milionë euro. Nga ky total, MTPL-ja e detyrueshme zë pjesën më të madhe (102,45 milionë euro).

Primet e shkruara bruto në sigurimin e pronës patën rritje me rreth 3.4% (e shprehur në terma vjetore). Si rrjedhojë e një klime dhe moti mjaft të butë vendi nuk pati problematikë dhe kjo solli një rënie gati 11% të dëmeve të paguara për sigurimin e pronës.

Një tjetër zhvillim i rëndësishëm në tregun e sigurimeve lidhet me vendimin e qeverisë së Federatës së Bosnje-Hercegovinës (FBiH) e cila miratoi ndryshimin në ligjin për sigurimin e detyrueshëm motorik. Ky ndryshim ligjor zgjat përdorimin e tarifës së përbashkët me një vit (deri në fund të tetorit 2023), ndërsa liberalizimi i plotë i tarifave u shty deri më 1 nëntor 2026.

Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm të Trafikut, i miratuar në gusht 2020, parashikon një derregullim dhe liberalizim me faza të tarifave të sigurimit MTPL për një periudhë gjashtëvjeçare, duke çuar në një treg të MTPL plotësisht të liberalizuar.

Megjithatë, si siguresit ashtu edhe autoriteti rregullator i tregut konsideruan se liberalizimi i çmimeve MTPL do të ishte i parakohshëm, duke nxitur një konkurrencë më të lartë në treg dhe ndoshta duke çuar në luhatje të çmimeve të MTPL-së me një ndikim negativ në të ardhurat e siguresve.

Një situatë e ngjashme është hasur edhe në subjektin tjetër administrativ të Bosnje-Hercegovinës, në Republikën Serbe të Bosnjës (RS), ku janë bërë ndryshime në ligjin për sigurimin e detyrueshëm që në vitin 2015, duke parashikuar shtyrjen e procesit të liberalizimit. Vendimi erdhi pas kërkesës së siguresve të RS, të cilët ndiheshin ende të papërgatitur për të përballuar procesin sfidues, si në aspektin e kapitalit ashtu edhe të burimeve njerëzore.

KROACI

www.xprimm.com

Sipas statistikave tremujore, të publikuara nga Byroja Kroate e Sigurimeve (*Croatian Insurance Bureau – CIB*), primet e shkruara bruto të siguruesve kroatë në fund të tremujorit të tretë 2021 u rritën me 12.15% në terma vjetorë, duke arritur në 9.02 miliardë HRK ose 1.20 miliardë euro. Dëmet e paguara bruto nga siguruesit në fund të tremujorit të tretë 2021 arritën në 5.19 miliardë HRK, duke u rritur me 9%.

Primet e shkruara bruto për sigurimin e Jo-Jetës u rritën me 12.90% duke arritur në 6.82 miliardë HRK, ndërsa segmenti i sigurimeve të Jetës raportoi prime prej 2.19 miliardë HRK, duke u rritur me 9.89% krahasuar me fundin e shtatorit 2020.

MALI I ZI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave tremujore të tregut të publikuara nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Malit të Zi, tregu vendas i sigurimeve arriti në 74.43 milionë euro në fund të shtatorit 2021, duke shënuar kështu një rritje prej 3.91% më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2020. Vëllimi i primeve të shkruara bruto për sigurimin e Jo-Jetës u rrit me 6.29% në vit duke arritur në 60.84 milionë euro, ndërsa segmenti i sigurimit të Jetës pësoi një rënie me 5.52% në vit, duke arritur në 13.59 milionë euro.

Gjatë periudhës janar-shtator 2021, siguruesit vendas kanë paguar dëme në vlerë prej 30.81 milionë euro ose rreth 22.10% më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë. Pjesa më e madhe e pagesave të dëmeve lidhet me sigurimet e Jo-Jetës, ku u paguan dëme me vlerë 23.50 milionë euro, ndërsa 7.32 milionë euro ishin pagesat e dëmeve në sigurimin e Jetës.

RUMANI

www.xprimm.com

Falimentimi i "CITY Insurance" vazhdon të jetë tema e nxehtë në tregun rumun të sigurimeve. Kjo kompani ishte më e madhja në tregun rumun, me një peshë prej 20% në totalin e industrisë së sigurimeve dhe 45% të tregut për produkte MTPL. Fokusi i debateve tashmë është krijimi i mekanizmave për një mbrojtje më të mirë të konsumatorëve dhe për një pagesë të shpejtë të dëmeve.

Në lidhje me këtë, UNSAR - Unioni Kombëtar i Kompanive të Sigurimeve dhe Risigurimeve në Rumani dhe BAAR - Byroja Rumune e Sigurimit Motorik kanë nxjerrë udhëzuesin e parë që ofron këshilla për njerëzit që kanë polica sigurimi me "CITY Insurance" dhe për ata që kanë pasur dëme në policat e siguruar në "CITY Insurance".

Duke iu referuar ndikimit në treg, dhe veçanërisht në linjën e sigurimit MTPL, UNSAR deklaroi se: "Ndikimi në këtë situatë është i ndjeshëm, por tregu i sigurimeve MTPL në Rumani do të vazhdojë të funksionojë dhe do ta kapërcejë këtë situatë. Mbjtësit e policave të sigurimit MTPL të lëshuara nga kjo kompani dhe të dëmtuarit mbrohen me ligj nëpërmjet mekanizmit mbrojtës, ndërtuar në këtë drejtim. ... Në të njëjtën kohë, ne vazhdojmë të mbështesim iniciativat legislative në përfitim të konsumatorëve dhe që sigurojnë një kuadër funksional optimal dhe të qëndrueshëm afatmesëm dhe afatgjatë."

SERBI

www.xprimm.com

Siguruesit serbë e mbyllën gjysmën e parë të vitit 2021 me një vëllim të primeve të shkruara bruto në vlerë 514 milionë euro, duke shënuar një rritje prej 8,2% në terma vjetorë. Gjatë së njëjtës periudhë dëmet e paguara ranë me rreth 2,3%, duke arritur në 203,3 milionë euro, rënie që erdhi kryesisht si pasojë e uljes së shpenzimeve për dëmet në linjat e sigurimit të pronës.

Sigurimet e pasurisë, veçanërisht dëmet në pronë, së bashku me klasat e sigurimit motorik, realizuan pjesën kryesore të rritjes së primeve, duke kontribuar me rreth 10.5 milionë euro në vëllimin e primeve të shkruara dhe rritjen e tij në vitin 2021. Sigurimi shëndetësor pati një rritje të primeve prej rreth 5 milionë euro, por njëkohësisht edhe rritje të dëmeve me rreth 3 milionë euro.

SLLOVENI

www.xprimm.com

Tregu i sigurimeve në vend e mbylli gjysmën e parë të vitit 2021 me një vëllim primesh të shkruara bruto me vlerë 1.4 miliardë euro, ose 2.84% më shumë se një vit më parë. Edhe dëmet e paguara u rritën me 3.97%, duke arritur në 810.4 milionë euro. Ritmet e rritjes ishin të krahasueshme si për sigurimin e Jetës dhe Jo-Jetës, dhe kështu edhe kontributi i tyre në rritjen e tregut, në terma absolutë, ishte gjithashtu i ngjashëm.

Në sigurimet e Jo-Jetës, rritja e primeve të shkruara bruto ishte rreth 2.75% (në terma vjetore) duke arritur në një total prej 1.02 miliardë euro. Kjo rritje u mbështet më së shumti nga klasat e sigurimit të pronës, për të cilat primet u rritën me 10.75% në vit. Një nga nxitësit kryesorë të kësaj rritjeje ishte rritja e ndërgjegjësimit pas tërmetit dramatik që goditi Kroacinë fqinje në fund të vitit 2020.

TURQI

www.xprimm.com

Zhvlerësimi i lirës turke në rezultatet e tregut të sigurimeve ishte ndikues gjatë gjysmës së parë të vitit 2021. Tregu pati një rritje nominale të primeve të shkruara bruto prej 17.11% (e shprehur në terma vjetore), duke arritur në 47.1 miliardë TRY, monedha vendase. Ky vëllim i primeve, i shprehur në euro, pësoi ulje në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. E shprehur në euro, vëllimi i primeve të shkruara bruto në nivel tregu arriti në 4.55 miliardë euro, pothuajse 13% më pak se në vitin e kaluar. Kontribuesit kryesorë në rritjen e tregut në monedhën vendase kanë qenë linjat e sigurimit të pronës, të sigurimit shëndetësor dhe sigurimi i mjeteve motorike.

Nga ana e tjetër, dëmet e paguara në sigurime u rritën me 36.34%, e shprehur në monedhën vendase duke arritur në 19.9 miliardë TRY. Rreth 60% e rritjes së dëmeve të paguara lidhej me linjat e sigurimit motorik. Sigurimet shëndetësore ishin burimi i dytë më i madh i shpenzimeve dhe rritjes së dëmeve të paguara, një evolucion i pritshëm në kushtet e pandemisë.



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al